

MENDIM PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYQTARËS NESRIN LUSHTA NË ÇËSHTJEN PENALE PML.nr.117/2014

Me datën 18.11.2014. kemi përfunduar këshillimin dhe votimin në lëndën PML.117/2014 sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës së qarkut në Pejë P.nr.477/11 të datës 24.05.2012 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.112/2012 të datës 25.04.2013.

Unë kamë shprehur mendim mospajtures me anëtarët e kolegjit, lidhur me:

- 1. përbërjen e kolegjit**
- 2. mundësinë e ndryshimit të aktgjyqimit për vendimin për dënimin**

1.

Përbërja e kolegjit

Konsiderojë se përbërja e kolegjit duhej të jetë me shumicë të gjyqtarëve vendor dhe këtë e bazojë në faktet si në vijim:

Sipas nenit 3. të Ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit nr.03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, të cilës i është shtuar neni 1.A.3., për qëllime të këtij ligji rast në proces nënkupton:

- 1.1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin;
- 1.2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

Neni 3.3. i këtij Kodi përcakton se kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve vendorë dhe do të kryesohen nga një gjyqtarë vendor. Me kërkesën a bazuar të autoritetit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të vendosë që kolegji të përbëhet më shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Sipas nenit 2. të Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me aspektet përkatëse të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët të Kosovës që punojnë në gjykatat vendase,

rastet të cilat sipas nenit 1.A.2 u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të nenit 25.1.dhe 242.2.të Kodit të Procedurës Penale (KPK) përpara datës 15 prill 2014

do trajtohen si raste në proces në fazat përkatëse të procedurës penale dhe shkallët e gjykimit. Kjo do të thotë se në të gjitha rastet në proces me trupa gjykues të përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it do të vazhdojnë të kenë shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it në këto trupa gjykuese për vazhdimin e të gjitha fazave të gjykimit dhe në pjesën e mbetur të procedurave.

Se rasti në fjalë është “rast në proces”, pajtohem plotësisht.

Megjithatë, nuk pajtohem se rasti duhet të trajtohet në kolegji të përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Në dispozitën e lartpërmendur të Marrëveshjes gjithnjë flitet për “trupat gjykues”. Pra, unë ashtu edhe e kuptojë këtë dispozitë. Rastet në proces me *trupa gjykues* të përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it do të vazhdojnë të kenë shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it sipas kësaj dispozite.

Në rastin konkret ne nuk kemi gjykuar në “trup gjykues” por në “kolegj”.

Se çka është kuptimi i këtyre termeve, përcaktohet me KPPK dhe

Sipas nenit 19.1.22. të KPPK trup gjykues është trupi i përbërë prej kryetarit të trupit gjykues dhe dy gjyqtarëve profesional të cilët shqyrtojnë provat dhe gjykojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Se trupi gjykues vepron vetëm në shqyrtimin gjyqësor, del edhe nga dispozita e neneve 25. e 26. të KPPK.

Termi “kolegji”, sipas nenit 28 të KPPK i referohet kolegjit i cili shqyrton ankesën, e kur është fjala për mjetet e jashtëzakonshme juridike, si në rastin konkret, sipas dispozitës së nenit 435.1 të KPPK: “Për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë vendos Gjykata Supreme në *seancë të kolegjit*”.

Vlerësojë se nga këto dispozita qartazi del se në rastin konkret nuk ka qenë fjala për trup gjykues por për kolegji dhe për këtë arsye nuk mund të aplikohet dispozita e Marrëveshjes për përbërjen e trupit gjykues me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Unë vlerësova edhe pjesën e dispozitës së lartë cekur e cila thotë se në këto raste trupi gjykues me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it do të jetë/vazhdojë në të gjitha fazat e gjykimit në pjesën e mbetur e procedurave.

Dispozita është kundërthënëse sepse fletë për “fazat e gjykimit” në “pjesën e mbetur e procedurave”. Fjala gjykim asnjëherë nuk i referohet seancës së kolegjit. Për këtë arsye unë kuptojë se kjo i referohet shqyrtimit në shkallën e parë, ndërsa pjesa e mbetur e procedurave, nëse intenca ka qenë referimi për procedurat me mjete juridike, është deshtë të precizohet.

2.

Mundësia që aktgjykimi të ndryshohet lidhur me vendimin për dënimin, me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sipas dispozitës së nenit 432.të KPPK mund të paraqitet për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të precizuara në pikat 1.2.dhe 1.3.të këtij neni.

Shkeljet esenciale të dispozitave procedurës penale janë cekur në dispozitën e nenit 384.të KPPK, ndërsa shkeljet e ligjit penal në dispozitën e nenit 385.të KPPK.

Në këtë vend do ta citojë nenin 385.të KPPK.

1. Shkelje e ligjit penal ekziston kur:

1.1. vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale;

1.2. ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;

1.3. ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkuar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;

1.4. lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet;

1.5. në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore; ose

1.6. janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të mbajtur.

Andaj, vendimi për dënim mund të atakohet me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë vetëm nëse gjykata me rastin e marrjes së vendimit ka tejkaluar kompetencat ligjore (p.sh. ka shqiptuar dënim me kusht edhe pse ky dënim nuk ka mundur të shqiptohet as me zbutje të dënimit; ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 vitesh për veprën penale për të cilën maksimumi i dënimit të paraparë me ligj është 5 vjet burgim dhe nuk ka kushte për ashpërsimin e tij etj.). Mirëpo, kjo paraqet shkelje të ligjit penal dhe jo vendimit për dënim, të cilin gjykata e merr pa

tejkalimin e autorizimeve që i ka ligj. Kjo është e qartë nga dispozita e nenit 387.të KPPK të cilën po ashtu do te citojë.

Neni 387.

Ankesa kundër aktgjykimit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal dhe vendimeve të tjera

1. Ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë lidhur me vendimin mbi shqiptimin e dënimit ose vërejtjes gjyqësore kur gjykata, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përkundër mos tejkalimit të kompetencave ligjore nuk e ka caktuar drejt dënimin ose vërejtjen gjyqësore.

2. Ndaj aktgjykimit gjithashtu mund të ushtrohet ankesë kur gjykata ka zbatuar ose nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen ose lirimin nga dënimi apo të vërejtjes gjyqësore.

3. Vendimi për masën e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga droga ose alkooli ose për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale mund të kundërshtohet kur gjykata, përkundër faktit se nuk ka bërë shkelje të nenit 385, nën-paragrafi 1.5. i këtij Kodi, ka marrë vendim jo të drejtë ose nuk e ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm me rehabilitim për personat e varur nga droga ose alkooli ose masën për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, përkundër ekzistimit të bazës ligjore për këtë.

Unë kuptojë se këtu është fjala për lartësinë e dënimit ose llojin e tij të cilën gjykata e ka shqiptuar, por sipas ankuesit, lloji dhe lartësia e dënimit janë përcaktuar ashpër ose butë, si pasojë e mos vlerësimit apo vlerësimit jo adekuat të rrethanave nga neni 73.të KPK.

Përfundimi im është se me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, kur është fjala për vendimin për dënim, aktgjykimi nuk mund të atakohet sipas nenit 387. por vetëm sipas nenit 385.1.5.të KPPK dhe nuk pajtohem me anëtarët e kolegjit se aktgjykimi mund të ndryshohet dhe të dënuarit të shqiptohet dënimi më i butë, sepse kërkesa nuk është paraqitur me pretendim të shkeljes së ligjit penal nga neni 385.1.5.të KPPK.

Gjyqtarja

Nesrin Lushta